



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP nr. 324/2024**

**Data e Vendimit: 21.05.2024**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) "KFP\_DDD" lidhur me aktivitetin e prokurimit "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me numër të prokurimit 616-24-2103-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës zv. Kryesuesi i Sekretariati të OSHP-së me datë 21/05/2024 mori këtë:

**VENDIM**

I. Hedhet si e palejuar, ankesa e OE "KFP\_DDD" me nr. të protokollit 2024/0324, e datës 15.04.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës", me numër të prokurimit 616-24-2103-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës.

II.I lejohet, Autoritetit Kontraktues që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës", me numër të prokurimit 616-24-2103-2-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

**Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 15.04.2024, tek

rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE “KFP\_DDD” për aktivitetin e prokurimit me “34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit 616-24-2103-2-1-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave ka bërë verifikimin se ankesa a është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, dhe ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë nuk ka kryer pagesën siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesën e lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin (dëshminë) e bankës për tarifën, edhe pse zyra për pranimin e ankesave me datën 22.04.2024 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se pas ekzaminimit të shkresave që i keni bashkangjitur në platformën e-prokurimet, OSHP ka konstatuar se OE ankues nuk ka kryer pagesën siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 69 të Rregullores për Prokurim Publik nr 001/2022 citojmë nenin 69 paragrafi .2 *“Në përputhje me nenin 118 të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP. a. Kurdo që ankesa ndërlihet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5, 000 Euro”.*

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE “KFP\_DDD”, e datës 15.04.2024 (protokoll 0324/2024), për aktivitetin e prokurimit me titull “34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës” me numër të prokurimit 616-24-2103-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues-Komuna e Prishtinës konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës”, me numër të prokurimit 616-24-2103-2-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veprojnë konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Zv. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

lxl AK - Komuna e Prishtinës

lxl OE - "OE "KFP\_DDD".

lxl Arhives se OSHP-së;

Agim Sheqiri  
Zv. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së

